



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.156 dt.06.11.1998

**“PËR NDARJE NE PARIM TE APARTAMENTEVE NE
BLLOQET “M.KETA”, “A.VISHA”, DHE “R.CUKA”.**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur në dt.06.11.1998, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Ndërtim Strehimit “Për ndarje në parim të apartamenteve në Blloqet “M.Keta”, “A.Visha”, dhe “R.Cuka”, mbështetur në Ligjin Nr.7652, dt.23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në V.K.M. Nr.46, dt.29.01.1993. “Për trajtimin e banesave në proces nga viti 1992”, në V.K.M. Nr.49, dt.29.01.1993, “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët” në V.K.M. Nr.530, dt.17.10.1994, “Për mënyrën e ndarjes së apartamenteve të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banësive”, bazuar dhe në Ligjin Nr.8030, dt.15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, si dhe në Ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”,

V E N D O S I

1. Të miratojë në parim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ndërtim Strehimit për të pajisur me autorizim definitiv familjet që banojnë në këto apartamente të cilat plotësojnë kërkesat ligjore dhe njëkohësisht nuk kanë konflikte me qytetarë të tjerë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve (Drejtorja e Ndërtim Strehimit) për të zbatuar këtë Vendim.

3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI